



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e dates 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 12 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.03.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NNDARJEN E MJETEVE FINANCIARE SHOQATËS
SINDIKALE TE ADMINISTRATËS KOMUNALE

Neni 1

I ipet pëlqimi Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare, në shumë prej 9000 €, (nëntë mijë) euro Shoqatës Sindikale të Pavarur të Administratës Komunale, sipas kërkesës së tyre të datës 24.03.2026, me qëllim të mbështetjes financiare për realizimin e vizitës dy ditore jashtë territorit të Republikës së Kosovës për të gjithë stafin punues të Administratës Komunale .

Neni 2

Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2026, mjetet e buxhetit të komunës, kod i programit 21/613/85003/200/00000/0820.

Neni 3

Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-400/01-15246
Lipjan, më 31.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi